



Numri i lëndës: 2024:049210

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428493

**C.nr.852/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË VITI**, gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtorin profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditëses F.D. nga V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.A., avokat në Viti, kundër të paditurës Komuna Viti-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 584.50 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 08.03.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. Apropohet** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.D. nga V., **detyrohet** e paditura Komuna Viti-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, për 187 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 22.01.2021 deri me datë 23.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën **374 €**, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita kur është ushtruar padia me datë 12.02.2024 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**II. Refuzohet** e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses për kompensimin e shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, në shumën 210.50 €.

**III. Detyrohet** e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

### **A r s y e t i m**

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 12.02.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit 584.50 €.

Me padi, paditësja ka theksuar se është e punësuar në shkollën e mesme të ulët “Bafti Haxhiu” në Viti, ashtu që në emër të shpenzimeve për ushqim dhe udhëtim, nga gjykata ka kërkuar që për periudhën nga data 22.01.2021 deri me datë 23.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 374 € si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t'ia paguajë shumën 210.50 € apo 50 % të pagës bazë, në shumë të përgjithshme 584.50 €. Bazën ligjore e ka mbështetur në Kontratën kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të vitit 2017 dhe 2021. Për të mbështetur pretendimet si në padi, si prova ka propozuar Vërtetimin e punës nr.

Numri i lëndës: 2024:049210  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05428493

251/23, të datës 05.12.2023 dhe Listën e pagave EM00130254. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet që dalin nga KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror e po ashtu, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës / Ministria e Arsimit e ka shkëputur këtë kontratë dhe rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses në tërësi të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditëses si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia”.

Gjykata në këtë çështje juridike civile, ka gjetur se faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës, lartësia e pagës e poashtu se nga data 22.01.2021 deri me datë 23.11.2022, paditësja ka qenë e pranishme në punë 187 ditë, pasi edhe e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Meqë baza ligjore e kërkesëpadisë së paditëses mbështetet në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), nenin 245, par. 1, në të cilin është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij” lidhur me nenin 35, par. 7 të KKAK-së, në fuqi nga data 18.04.2017 dhe ajo KKAK në fuqi nga data 21.01.2021, sipas të cilit është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Bazën ligjore të kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, paditësja e ka mbështetur në nenin 35, par. 8, pika 8.1 të kontratës, ku është përcaktuar se: “Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të

Numri i lëndës: 2024:049210  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05428493

pagës bazë” mirëpo, meqenëse paditësja vitin e 10 jubilar e ka arritur në vitin 2023 (fakt ky i vërtetuar përmes listës së pagave në emër të paditëses), ndërsa kontrata ka qenë në fuqi vetëm deri me datë 22.11.2022 dhe pas kësaj date e njejta nuk krijon të drejta dhe detyrime për palët, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara pasi kërkesa e paditëses është për periudhën sa kanë qenë në fuqi KKAK e vitit 2017 dhe 2021 ndërsa, palët kontraktuese të KKAK-së Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” ndërsa, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate.”

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditësit në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI  
C.nr.852/2024, datë 08.03.2024

G j y q t a r i,  
Raif Fazliu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.